



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 604/15 prot.

Datë 23.04.2025

V E N D I M

Nr. 540/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.04.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.499/2025, datë 14.04.2025, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-24488-10-14-2024, me objekt “Ndërtim i sistemit të kanalizimeve të Njësisë Administrative Udenisht, Bashkia Pogradec” me fond limit: **1.003.545.198,34** (një miliard e tremilion milion pesëqind e dyzet e pesë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë tridhjet e katër), zhvilluar në datën 24.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec SH.A.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “REJ” SHPK, me NIPT J93711608Q, me adresa: Sheshi “Evropa”, Pogradec.
- Subjekt i interesuar:** Operatori ekonomik “4 A-M” SHPK, me NIPT K92005016L dhe me adresë Tiranë, Rruga “Artan Lenja”, Pallati i 4 A-M, Apartamenti A1, kati i I-rë.
- Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec sh.a
Adresa: “Rruga e Gurasit”, Guras, Pogradec.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.

766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 14.04.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.499/2025, ku vendosi:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “REJ” Shpk, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-24488-10-14-2024, me objekt “Ndërtim i sistemit të kanalizimeve të Njesisë Administrative Udenisht, Bashkia Pogradec” me fond limit: **1.003.545.198,34** (një miliard e tremilion e pesëqind e dyzet e pesë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e katër), zhvilluar në datën 24.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “REJ” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën me datë 18.04.2025 dërguar nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, protokolluar me tonën nr. 604/10 prot., datë 18.04.2025, autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec sh.a. njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 499/2025, datë 18.04.2025, si vijon: “.....ju bëjmë me dije se, Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka kryer rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin e sipërcituar”.

I.3. Me shkresën me nr. 319 prot., datë 18.04.2025 dërguar nëpërmjet shërbimit postar, protokolluar me tonën nr. 604/11 prot., datë 22.04.2025, autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec sh.a. njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 499/2025, datë 18.04.2025, si vijon: “.....ju bëjmë me dije se, Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka kryer rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin e sipërcituar”.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën me datë 18.04.2025 dërguar nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, protokolluar me tonën nr. 604/10 prot., datë 18.04.2025, autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec sh.a. njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 499/2025, datë 18.04.2025, si vijon: “.....ju bëjmë me dije se, Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka kryer rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin e sipërcituar”.

II.2. Me shkresën me nr. 319 prot., datë 18.04.2025 dërguar nëpërmjet shërbimit postar, protokolluar me tonën nr. 604/11 prot., datë 22.04.2025, autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec sh.a. njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 499/2025, datë 18.04.2025, si vijon: “.....ju bëjmë me dije se, Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka kryer rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin e sipërcituar”.

II.3. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik si edhe informacioni i dërguar nëpërmjet sistemit elektronik dhe shërbimit postar më datë 18.04.2025, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kryer ri-vlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik dhe ka rivlerësuar operatorët ekonomikë, “REJ” SHPK dhe “4-AM” SHPK në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.499/2025, datë 14.04.2025, duke i rivlerësuar me pikë në lidhje me kriterin e stafit/organizimi i kompanisë dhe kriteri propozime për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, për këta dy ofertues të kualifikuar, ku këto veprime janë pasqyruar nga autoriteti kontraktor me informacionin e dërguar.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-24488-10-14-2024, me objekt “Ndërtim i sistemit të kanalizimeve të Njësisë Administrative Udenisht, Bashkia Pogradec” me fond limit: **1.003.545.198,34** (një miliard e tremilion milion pesëqind e dyzet e pesë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e katër), zhvilluar

në datën 24.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec SH.A.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Fiorent Zguro	Anila Malaj	Kreshnik Ternova	Gjergj Mersini
	Kryetar		
	Jonaid Myzyri		

